




Pranuar / Dostiguar Prilazhen / Prilazho Received / Dostigary	29.12.2023	3	VITI GOD YEAR
Organ / Agjencia Organ / Jedinstva Org / Inst	SKINSHEK	7758/2023	Sasia Kolicina Quantity
			114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.366/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.366/2019 të datës 02.07.2019 të parashtruar nga ankuesi sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2511/2022 të datës 22.06.2023 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.366/2019 të datës 02.07.2019 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike, në bazë të nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 8 të Rregullores Nr.06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, më datë 11.04.2019 ka shpallur konkursin për pozitën „ Drejtor i Përgjithshëm” në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

Ankuesi më datë 24.04.2019 ka aplikuar në këtë konkurs dhe i njëjti ka plotësuar kriteret e konkursit dhe ka hyrë në listën e ngushtë, gjithashtu ka marrë pjesë edhe në intervistë me gojë, ndërsa më datë 20.05.2019 Komisioni për Vlerësimin e Kriereve për pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës”, pas mbajtjes së intervistës me gojë ka publikuar njoftimin për kandidatët e suksesshëm.

Kundër njoftimit të datës 20.05.2019, ankuesi ka parashtruar ankesën me numër protokolli Nr.1769 në Komisionin e Ankesave për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues në Ministrinë e Administratës Publike. Më datë 05.06.2019 Komisioni për Ankesa për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues ka nxjerr Vendimin me numër protokolli Nr.1835 përmes së cilit ankesa me numër protokolli Nr.1769 e datës 27.05.2019 e parashtruar nga ankuesi është refuzuar si e pa bazuar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokolli Nr.1769 të datës 27.05.2019 të Komisionit të Ankesave për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, më datë 02.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2966/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se përzgjedhja e tre kandidatëve të publikuar për emërim në pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“, është në kundërshtim me Rregulloren 17/2018 për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues përkatësisht nenin 12, pika 2.3 dhe 3.1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.07.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuese në Ministrinë e Administratës Publike. Ndërsa Këshilli nga kjo e fundit më datë 27.03.2019, ka pranuar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mungesës së kuorunit, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa me datën 04.09.2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 11.07.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2511/2022, i përmes së cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.09.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e datës 02.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2511/2022 të datës 22.06.2023 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokolli 2966/2019 të datës 02.07.2019; Vendimin me numër protokolli 1837 të datës 05.06.2019; Ankesën me numër protokolli 1769 të datës 27.05.2019 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin e ankesave për pozitat e nivelit të lartë drejtues në MAP; E-mailin e datës 02.07.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3036/2019; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2384 të datës 23.07.2019; E-mailin e datës 30.04.2019; Vendimin për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve me nr.13/2019 të datës 06.05.2019; Vendimin me Nr.13/1/2019 të datës 20.05.2019; Dëshmi e datës 11.04.2019; Lista e ngushtë përfundimtare e datës 07.05.2019; Konkursin e datës 11.04.2019; Vendimin me numër Nr.06/106 të datës 11.06.2019; Raporti i Komisionit të Vlerësimit të datës 20.05.2019; Aplikacioni i datës

25.04.2019; Letrën motivuese; Aplikacionet së bashku me dëshmitë e bashkangjitura për kandidatët e propozuar për emërim

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës pretendon se vlerësimi nga Komisioni për Vlerësimin e Kriterëve për përzgjedhjen e tre kandidatëve me të mirë për emërim në pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“, është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 të Rregullores(QRK)-nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës Së Kosovës, respektivisht ankuesi pretendon se kandidati A. A nuk i plotëson kriteret e konkursit konkretisht përvojën e punës ne nivelin drejtues.

Nga administrimi i shkresave të parashtruara nga ankuesja si dhe organi i punësimit, Kolegji ka gjetur se më datë 06.07.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka nxjerrë Vendim me numër A.nr.530/2022 përmes së cilit Vendim është konstatuar se kandidati fitues A.A i cili është emëruar për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“ ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.07.2019 me pretendimin ankimor se përzgjedhja e tre kandidatëve të publikuar për emërim në pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“, është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 të Rregullores(QRK)-nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës Së Kosovës, konkretisht ankuesi pretendon se kandidati A. A nuk i plotëson kriteret e konkursit konkretisht përvojën e punës ne nivelin drejtues dhe i njëjti pretendon që procedura e rekrutimit për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“, duhet te anulohet sepse është zhvilluar ne kundërshtim me dispozitat e Ligjin r.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me datë 09.07.2020), dhe kundërshtim me dispozitat e Rregullores(QRK)-nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse sipas Vendimit me numër A.nr.530/2022 te datës 06.07.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës është konstatuar se kandidati fitues A.A i cili është emëruar për pozitën „Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës“ ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, atëherë me këtë rast pretendimi i ankuesit është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjësisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: „Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë“, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se analizimit dhe vlerësimit te të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me

Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.366/2019 të datës 02.07.2019 të ankuesit [redacted] si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.366/2019.

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [redacted]
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

